



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR**

NJOFTIM

PËR

**SHPALLJEN E PROCEDURËS SË KONKURIMIT PËR HETUES NË SEKTORIN E
HETIMIT FINANCIAR NË PROKURORINË E POSAÇME.**

Prokuroria e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimtit të Organizuar shpall procedurën e konkurimit për 8 (tetë) vende vakante për Hetues në Sektorin e Hetimit Financiar pranë kësaj prokurorie.

Hetuesit e Sektorit të Hetimit Financiar në Prokurorinë e Posacme kanë përgjegjësinë të kryejnë verifikime të mjeteve financiare dhe pasurive të personave nën hetim dhe të raportojë rezultatet te prokurori i posaçëm kompetent.

Hetuesit kanë statusin e Oficerit të Policisë Gjyqësore. Paga e punonjësve të këtij sektori do të jetë në përputhje me parashikimet e nenit 21 paragrafi (4) dhe nenit 39/1 të ligjit nr.95/2016.

Sistemi i përzgjedhjes së hetuesve të Sektorit të Hetimit Financiar në Prokurorinë e Posacme është një proces sfidues, i përgatitur përfshirë gjetur kandidatët më të aftë dhe me integritet. Ata që janë të suksesshëm në procesin e përzgjedhjes do t'i bashkohen një skuadre që mbështet prokurorët e Prokurorisë së Posacëme të cilët do të ndjekin dhe hetojnë veprat penale në fushën e korrupsionit dhe krimtit të organizuar sipas kompetencës lëndore të parashikuar në ligjin 95/2016.

Kandidatët përfshirë Hetues në Sektorin e Hetimit Financiar në Prokurorinë e Posacme duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- 1) Të janë diplomuar në drejtësi, në financë apo në fusha të tjera përkatëse, të lidhura me fushën e hetimeve financiare;
- 2) Të kenë një eksperiencë pune jo më pak se 2 (dy) vjet si Oficerë të Policisë Gjyqësore;
- 3) Të plotësojnë kushtet e sigurisë përpëra emërimit në detyrë të parashikuara në nenin 6 të ligjit nr.95/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve përfshirë të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*”;

- 4) Të ketë plotësuar me sukses procesin e përzgjedhjes sipas procedurës së konkurimit të organizuar nga Prokuroria e Posacme.

Kandidatët për Hetues në Sektorin e Hetimit Financiar duhet të dorëzojnë në Prokurorinë e Posacme dokumentet e mëposhtme:

- a. Kërkesen për t'u emëruar hetues në Sektorin e Hetimit Financiar në Prokurorinë e Posacme;
- b. Jetëshkrimin e detajuar të kandidatit;
- c. Kopjen e diplomës dhe listës së notave, të arsimit të lartë dhe çdo dokument tjeter që tregon plotësimin e kriterit të arsimit, sipas ligjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;
- d. Librezën e punës ose çdo dokument tjeter qe vërteton përvojen në punë të kandidatit si oficer i policisë gjyqësore në sektionet e policisë gjyqësore, si oficer i policisë gjyqësore në shërbimet e policisë gjyqësore ose si oficer i policisë gjyqësore në organe dhe institucione të tjera të cilëve ligji iu ngarkon kompetanca të policisë gjyqësore dhe iu njeh atributet e policisë gjyqësore;
- e. Vlerësime të mëparshme të punës ose në mungesë të një vlerësimi pune, letër rekomandim nga eprori në institucionin aplikanti është i punësuar apo ka qënë i punësuar;
- f. Dëshmi të gjuhëve të huaja dhe dëshmi të trajnimeve që ka kryer (nëqoftë se ka);
- g. Dëshmi penaliteti që tregon se kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale dhe vërtetësia nga gjykata dhe prokuroria që vërtetojnë se nuk është në ndjekje penale apo gjykim për kryerjen e ndonjë vepre penale;
- h. Dokument që vërteton se ndaj kandidatit nuk ka në fuqi ndonjë masë disiplinore dhe se në momentin e konkurimit nuk ka filluar procedim disiplinor ndaj tij.

Kandidatët që shfaqin interes për të marrë pjesë në konkurim, në zbatim të nenit 6, paragrafi (2) të ligjit nr.95/2016, në momentin e aplikimit duhet të jasin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, duke nënshkruar dhe paraqitur deklaratën me shkrim sipas shtojcave B2 dhe B3 të këtij ligji.

Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet në Sektorin e Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Posacme, në origjinal ose në formën e njësuar me origjinalin. Kandidatët pajisen me vërtetim për dorëzimin e kërkesës dhe të listës së dokumentave.

Nëse vlerësohen si kandidatë të mundshëm, aplikantët do t'i nënshtrohen procesit të mëposhtëm të përzgjedhjes që do të organizohet në përputhje me Rregulloren nr.248, datë 27.04.2022 “Përcaktimin e rregullave për organizimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të Hetuesve të

Sektorit të Hetimit Financiar në Prokurorinë e Posaçme". Proçesi i përzgjedhjes do të kalojë në disa faza nëpërmjet një proçesi pikëzimi, ku përfshihen:

- a. Faza e parë, vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës në punë e të trajnimeve të lidhura me fushën;
- b. Faza e dytë, vlerësimi me shkrim;
- c. Faza e tretë, intervista e strukturuar me gojë;
- d. Faza e katërt, kontrolli i verifikimit të pasurisë dhe pastërtisë së figurës.

Prokuroria e Posaçme zbaton politikën e barazisë në të gjitha praktikat e punësimit. Barazia e mundësive është prioritet i lartë i Prokurorisë së Posaçme, nuk diskriminon asnjë kandidat në mënyrë të paligjshme, të padrejtë apo të paarsyeshme në bazë të gjinisë, statusit martesor, orientimit seksual, fesë apo besimit, racës, kombësisë apo origjinës etnike.

Afati i paraqitjes së aplikimeve dhe dokumentacionit shoqërues është 15 ditë nga momenti i publikimit të këtij njoftimi dhe përfundon në datën 12.05.2022, ora 16.00.